

Një Vështrim mbi Treguesit e Zhvillimit Ekonomik të Shqipërisë 6M I 2022

Sekretariati i Këshillit të Investimeve

Korrik 2022

Ky publikim është një përmbledhje e treguesve kryesorë makroekonomikë në Shqipëri të publikuara nga burime zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ky dokument nuk paraqet pikëpamjet e Sekretariatit ose Këshillit të Investimeve.



Përmbajtja

- Llogaritë Kombëtare
- Tregtia e Jashtme
- Tregu i Punës
- Investimet
- Tregues Monetar
- Renditja e Shqipërisë sipas:
 - Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit
 - Indeksi i Lirisë ekonomike
 - Indeksi Global i Inovacionit


Ecuria e Treguesve Kryesore Makroekonomikë

- ❖ Përgjatë vitit 2021, ekonomia u rrit me 8,4% krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa gjatë TI-2022 **ekonomia u rrit me 5,97%**, kryesisht nga ndikimi i sektorit të ndërtimit dhe tregtisë.
- ❖ **Inflacioni** gjatë vitit 2021 mbeti nën objektivin e Bankës së Shqipërisë prej 3%, duke regjistruar vlerë mesatare vjetore prej 2,1% por me tendenca rritëse, dhe gjatë 6MI-2022 **arriti vlerën 5,6%**.
- ❖ Gjatë TI-2022, **fluksi hyrës i IHD u rrit me 16,7%** krahasuar me një vit më parë, ndërkohë, **stoku i IHD u rrit me 11,7%** krahasuar me një vit më parë duke arritur 9.762 milionë Euro. **Gjermania** është vendi me **fluksin më të lartë të IHD-ve** për TI-2022, 33 milionë Euro, ndërkohë, **Zvicra** vazhdon të **udhëheqë stokun e IHD-ve** në vend edhe për Tremujorin I 2022, me 1.755 milionë Euro.
- ❖ Në 2021, norma zyrtare e papunësisë regjistroi shifrën 11,6% me rrënie 0,1 p.p krahasuar me një vit më parë. Në TI-2022, **norma e papunësisë arriti 11,3%**, në rënie krahasuar me tremujorin paraardhës.



Rritja Ekonomike Sipas Tremujorëve


Rritja tremujore PBB në %



Produkti i Brendshëm Bruto (P.B.B) në tremujorin e parë të vitit 2022 vlerësohet **me rritje prej 5,97%**, kundrejt tremujorit të parë të vitit 2021. Një vit më parë kjo rritje ishte 4,27 %.

Rritja Ekonomike Sipas Tremujorëve

Rritja vjetore tremujore sipas aktiviteteve të ekonomisë




Gjatë TI 2022, rritje përjetuan aktivitetet: Ndërtimi, Aktivitete të Pasurive të Paluajtshme, Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor, Informacioni dhe Komunikacioni, Aktiviteti Financiar dhe i Sigurimit, grupi i Aktiviteteve profesionale dhe Shërbime administrative, Industria Energjia dhe Uji dhe Bujqësia, Pyjet dhe Peshkimi.

Me rënie u shfaqën Administrata Publike, Arsimi dhe Shëndetësia si edhe Arte, argëtim dhe çlodhje, Aktivitete të tjera shërbimi.

Rritja Ekonomike Sipas Tremujorëve


2022-TI Kontributi në rritje p.p sipas aktiviteteve të ekonomisë



Kontribut kryesor pozitiv në rritjen e TI 2022 kanë dhënë degët: Ndërtimi me **+1.95 p.p.**, Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor me **+1.55 p.p.**, Aktivitete të pasurive të paluajtshme me **+0.91 p.p.**, Aktivitete profesionale dhe Shërbime administrative me **+0.66 p.p.**

Negativisht kontribuan aktivitetet: Arte, argëtim dhe çlodhje; aktivitete të tjera shërbimi me **-0.35p.p.**, Administrata publike, Arsimi dhe Shëndetësia me **-0.18 p.p.**

Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme




Gjatë 6MI të vitit 2022 **eksportet e mallrave** arritën vlerën 253 mld lekë, duke u **ritur me 43%**, ndërkohë **importet e mallrave** arritën vlerën 446 mld lekë, duke u **ritur me 26%**, krahasuar me një vit më parë.

Deficiti tregtar arriti vlerën 193 mld lekë, duke u **ritur me 8,7%**, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021.

Përqindja e mbulimit të eksporteve ndaj importeve u **rit në 56,7%**

Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme

Importet sipas grupmallrave (në million lekë)




Importet në 6MI 2022 janë **ritur me 25,9%**, krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2021.

Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me **+10,7 p.p.**, “Materiale ndërtimi dhe metale” me **+4,8 p.p.** dhe “ Ushqime, pije, duhan” me **+3,9 p.p.**

Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme

Eksportet sipas grupmallrave (në milionë lekë)



Eksportet, gjatë 6MI 2022 janë **rritur me 43,3%**, krahasuar me një vit më parë.


Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me **+13,7 p.p.**, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me **+12,2 p.p.**, dhe “Tekstile dhe këpucë” me **6,9 p.p.**



Importet e Mallrave

Struktura e importeve të mallrave gjatë 6M-I 2022 dominohet nga importet e Makineri, pajisje, Ushqimeve, pije, duhan dhe Materiale ndërtimi dhe metale.


Struktura e Importeve (në %)





Eksportet e Mallrave


Struktura e Eksporteve (në %)



Eksportet sipas produkteve vazhdojnë të ruajnë strukturën e tyre ku pjesa më e madhe janë Tekstile dhe Këpucë të ndjekur nga Materiale ndërtimi dhe metale dhe Minerale lëndë djegëse, energji elektrike.



Indeksi i Çmimit të Konsumit




Përgjatë 6MI 2022, **inflacioni mesatar** me bazë vjetore rregjistroi vlerën **5,6%**, më i lartë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku Inflacioni rregjistroi vlerën **1,4%**.

Bazuar në të dhënat e grafikut, duke filluar nga fundi i vitit 2011, inflacioni mujor me bazë vjetore ka qenë vazhdimisht poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 3%, por tendenca rritëse janë vënë re duke filluar nga muaji nëntor 2021, ku Inflacioni i regjistruar tejkaloi objektivin e BSH me ritme të larta.



Kursi i këmbimit


Kursi mesatar i këmbimit




Përgjatë 6M I të vitit 2022 kursi mesatar i këmbimit Lekë/Euro ishte 121,15 ndërsa Lekë/USD ishte 110,79

Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë në ekonomi (mln Lekë)




Kredia e re 6MI 2022 sipas aktivitetit ekonomik mln Lekë



Kredia totale për ekonominë në Qershor 2022 arriti në **701 miliardë Lekë** ndërsa shumica e kredisë së re gjatë 6MI të vitit 2022 shkoi në **tregtinë me shumicë dhe pakicë, ndërtimi dhe industria përpunuese** duke vazhduar të njëjtin trend të një viti më parë.

Forca e Punës

Norma e papunësisë




Në TI 2022, bazuar në të dhëna e publikuara, **shkalla e papunësisë u ul me 0,1 p.p.** krahasuar me një tremujor më parë.

Referuar të dhënave të INSTAT në TI 2022, **numri i të punësuarve u rrit me rreth 2,268 persona** krahasuar me një tremujor më parë.

Paga Mesatare sipas Sektorëve (Në Lekë)

Paga mesatare mujore bruto sipas aktivitetit ekonomik




Pagat më të larta, edhe gjatë TI 2022 vazhdojnë të regjistrohen në sektorin e “Aktiviteteve financiare dhe sigurimit”, pasuar nga “Informacioni dhe Komunikimi”.

Pagat më të ulta janë raportuar në sektorin “Bujqësi, Silvikulturë dhe Peshkim”.



Paga Mesatare dhe Paga minimale





Paga mesatare gjatë TI 2022 (referuar të dhënave zyrtare të publikuara) është raportuar në **57.242 Lekë** me rënie nga tremujori paraardhës.

Paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin privat ishte **55.638 lekë** me një rritje **2,1%** krahasuar me një vit më parë ; Ndërkohë paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin shtetëror ishte **67.045 lekë** , me një rënie **5%** krahasuar me TIV 2021.



Shënim: të dhënat janë mesatare të shifrave tremujoreve publikuar nga INSTAT

Investimet e Huaja Direkte



Gjatë TI 2022, fluksi hyrës i IHD u rrit me 16,7% krahasuar me një vit më parë, dhe janë ulur me 9,6% krahasuar me tremujorin paraardhës. Ndërkohë, stoku i IHD u rrit me 11,7% krahasuar me një vit më parë duke arritur 9.762 milionë Euro dhe 2,3% më shumë se tremujori IV 2021.

Investimet e Huaja Direkte




Gjermania është vendi me fluksin më të lartë të IHD-ve për TI 2022, 33 milionë Euro e ndjekur nga Italia me 30 milionë Euro dhe Turqia me 30 milionë Euro. Holanda, si vendi me flukset më të larta përgjatë 2021, i ka reduktuar flukse hyrëse në TI 2022 në 22 milionë Euro.

Ndërkohë, **Zvicra** vazhdon të udhëheqë stokun e IHD-ve në vend edhe për tremujorin I 2022, me 1.755 milionë Euro në rënie nga TIV 2021.



Investimet e Huaja Direkte


Fluksi IHD sipas aktiviteteve kryesore në mln Euro



Gjatë TI 2022, sektori më tërheqës për IHD-të është **Aktivitete të pasurive të paluajtshme** e ndjekur nga Energjia elektrike dhe Industria nxjerrëse .

Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit

Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit, Renditja në 180 vende



Shqipëria renditet e **110/180** në rang botëror, duke përkeqësuar pozicionin e saj nga viti i kaluar.


Shqipëria e ka ulur vlerësimin e indeksit nga nga 36 një vit më parë, në 35 për vitin 2021.

Mal i Zi ka renditjen më të mirë nga të gjitha gjashtë vendet në rajonin e Ballkanit Perëndimor (64/180).



Liria Ekonomike

Trendi i Lirisë Ekonomike, Shqipëria (177 vende të vlerësuara)




Shqipëria renditet e **50a** në rang botëror, duke përmirësuar pozicionin e saj nga viti i kaluar


Në rang rajonal, Shqipëria renditet e **30a** nga 45 vende europiane

Vendi qëndron poshtë mesatares europiane (**69.5**) por është mbi mesataren botërore (**60**)

Treguesit e Lirisë Ekonomike - Indeksi në vite




Në Sundimin e Ligjit, Shqipëria ka përmirësuar rezultatin e saj në të Drejtat e Pronësisë dhe Efektiviteti Gjyqësor, ndërkohë që ka përqësuar në indeksin e Integritetit të Qeverisë.




Përsa i përket Efektiviteti Rregullator, Shqipëria ka përmirësuar indeksin e saj në Lirinë e të bërit biznes, ndërsa nuk ka përmirësuar në Lirinë e Punës dhe Lirinë Monetare.

Treguesit e Lirisë Ekonomike - Indeksi në vite



Sipas Madhësisë së Qeverisë, gjatë vitit 2022 nuk ka ndryshim të madh në Indeksin e Barrës Tatimore, ndërkohë që ka përkeqësim të Indeksit për Shëndetin Fiskal, por asnjë ndryshim në Indeksin e Shpenzimeve Qeveritare.



Përsa i përket Lirisë së të bërit biznes, nuk ka ndryshim në Indeksin e Lirisë së Investimeve dhe Lirisë Financiare, ndërsa Indeksi i Lirisë së Tregut ka pësuar një rënie të lehtë.


Indeksi Global i Inovacionit - Renditja në nivel global

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
SRB	70	65	58	56	57	53	54
MNE	40	46	52	55	45	49	50
ALB	112	71	115	83	70	83	84
MKD	55	62	63	84	59	57	59
BIH	122	104	86	68	71	74	75

Shqipëria renditet e **84-ta** në Indeksin Global të Inovacionit për vitin 2021, e fundit në rajon; Mali i Zi kryeson rajonin në Inovacion sipas raportit të fundit të GII

Indeksi Global i Inovacionit - Renditja në 132 ekonomi

Indeksi Global i Inovacionit, 2021 Renditja në 132 ekonomi të vlerësuara



Shqipëria renditet më ulët në Njohuri dhe prodhim teknologjik, Kërkimi dhe Kapitali Njerëzor, Prodhimi Kreativ dhe Sofistikimi i Tregut

Rreth Këshillit të Investimeve në Shqipëri

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Stafi

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË



European Bank
for Reconstruction and Development



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).